



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**VENDIMI
PËR MIRATIMIN E LISTAVE SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË NË
KËSHILLIN E BASHKIVE TË DEPOZITUARA NGA PARTIA ALEANCA PËR DEMOKRACI DHE
SOLIDARITET, PJESTARE E KOALICIONIT "ALEANCA PËR SHQIPËRINË EUROPIANE",
PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 22.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive: Lezhë, Tiranë, Lushnje, Durrës, Shkodër të paraqitura nga "Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet", pjesëtare e Koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", dhe neni 73, pika 1 dhe pika 2 të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga "Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet", si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N:

Me vendimin e KQZ-së nr.251, datë 7.05.2019, është regjistruar koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane", pjesë e të cilit është dhe Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet. Në bazë të nenit 67, dhe nenit 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", ka depozituar në KQZ listën shumemërore të kandidatëve të saj për anëtar në Këshillin e Bashkive: Lezhë, Tiranë, Lushnje, Durrës, Shkodër.

Në bazë të nenit 67, pika 3, KQZ duhet të regjistrojë kandidatët për kryetar apo për këshillin e bashkive: Lezhë, Tiranë, Lushnje, Durrës, Shkodër; pasi bashkitë Lezhë, Tiranë, Lushnje, Durrës, Shkodër, administrohen nga më shumë se një KZAZ.



Nr. 624 i Vendimit

Data 22.05.2019

Ora 17:00 e Vendimit

Për miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive të paraqitura nga "Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet", pjesëtare e Koalicionit "Aleanca Për Shqipërinë Europiane", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

KQZ me vendimet nr. 505 datë 17.05.2019, nr.556, datë 18.05.2019, nr.559 datë 18.05.2019 ka vendosur kthimin për plotësim të listës shumëmemërore të kandidatëve për këshillin e bashkisë Lezhë, Tiranë, Durrës.

Brenda afatit Bashkia Lezhë, nuk ka plotësuar dokumentacionin sipas vendimit të KQZ-së me nr. 505 datë 17.05.2019. Në këto kushte KQZ referuar nenit 73, pika 2 duhet të refuzojë listat e kandidatëve për Këshillin e bashkisë Lezhë, të Partisë Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet.

Bashkëlidhur kërkesës është depozituar dhe dokumentacioni përkatës, si më poshtë:

1. Listat shumëmemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive: Tiranë, Lushnje, Durrës, Shkodër.
2. Deklaratat e kandidatëve të listave shumëmemërore, të cilët deklarojnë se gëzojnë të drejtën dhe vullnetin për të kandiduar për anëtar këshilli në Këshillin e Bashkive: Tiranë, Lushnje, Durrës, Shkodër, të propozuar nga Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet;
3. Kopje të dokumentit të identifikimit për të gjithë kandidatët e listave shumëmemërore;
4. Vërtetim i Kuvendit të Shqipërisë, nr. 1851/1. prot., datë 09.05.2019, sipas të cilit vërtetohet se Partia Socialiste, përfaqësohet nga 74 deputetë në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.
5. Jetëshkrimin për të gjithë kandidatët e listës shumëmemërore;
6. Formularin e vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".
7. Procesverbal i dorëzimit të dokumentave të kandidimit.

Në mbledhjen e datës 22.05.2019 në bazë të nenit 73, të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikoi listat shumëmemërore të kandidatëve për këshillin e Bashkive Bashkive Tiranë, Lushnje, Durrës, Shkodër, të Partisë Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet dhe dokumentacionin bashkëngjitur të paraqitur dhe konstatoi se është në përputhje me kërkesat e parashikuara nga neni 67, pika 2, 4, 5 dhe 6 dhe neni 72 të Kodit Zgjedhor.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", verifikoi të dhënat në formularët e vetëdeklarimit për secilin kandidat të listës shumëmemërore. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, asnjëri prej tyre nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile nëpërmjet shkresave si dhe nëpërmjet postës elektronike për kandidatët për anëtarë në këshillin e bashkisë Tiranë, Lushnje, Durrës, Shkodër që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, nga ku rezulton se:

1- **BASHKIA SHKODËR, Shpëtim Preza, me numer rendor 11.** Në bazë të vendimit nr.333 dt.05.03.2007 të Gjykatës së rrethit Tiranë është deklaruar fajtor për "Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksion publike" dhe në bazë të nenit 259 K.P, 406/1 K.Pr.P është dënuar përfundimisht me 6(gjashtë) muaj burgim dhe 200.000(dyqind mijë) lekë gjobë. Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin NR. 671 dt.28.09.2007 ka vendosur lenien në fuqi . Rehabilitohet në bazë të nenit 69 të K.P. Në bazë të vendimit nr.333 dt.05.03.2007 të Gjykatës së rrethit Tiranë është deklaruar fajtor për veprën penale " Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksion publike" dhe në bazë të nenit 259 K.P, 406/1 K.Pr.P është dënuar përfundimisht me 6(gjashtë) muaj burgim dhe 200.000(dyqind mije) lekë gjobë. Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 671 dt .28.09.2007 ka vendosur lenien në fuqi Gjykata e lartë me vendimin n.355 dt. 26.06.2009 ka vendosur mospranimin e rekursit.



2. **BASHKIA SHKODËR, Skender Kulla me numer rendor 14.** Me vendim nr.24, datë 26.01.2001 Gjykata e rrethit Shkodër e ka deklaruar fajtor për mbajtje të substancave bimore për prodhimin e narkotikëve, e në bazë të nenit 285 K.P është dënuar me 1 (një) vit burgim. Bazuar në nenin 59.K.P. pezullimin e ekzekutimit të vendimit për një afat kohor prej dy vjetësh. Në bazë të nenit 69.K.P është rehabilituar.

3. **BASHKIA LUSHNJE, Ejup Xhaferi me nr rendor13.** Në baze te nenit 6 date 27.02.1980, Gjykata e Fierit Kol.Ushtarak e ka deklaruar fajtor për shkeljen e rregullave të shërbimit të rojes dhe në bazë të nenit 244 K.P, është dënuar me 4(katër) muaj riedukim. Në bazë të nenit 69.K.P është rehabilituar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, paragrafi i fundit, të kreut V të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, konstaton se për personat e shënuar në listën shumemërore të dhënat e tyre nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin si kandidatit për këshillin e bashkisë, sipas ligjit nr. 138/2015.

KQZ gjithashtu ka bërë publikimin e formularëve të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 73, pika 1, të Kodit Zgjedhor, në mbledhjen e datës 22.05.2015, verifikoi listat shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë, Lushnje, Durrës, Shkodër dhe dokumentacionin bashkëngjitur, të depozituar nga "Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet" dhe konstatoi se ishte në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 67, pikat 2, 4, 5, dhe 6, nenin 72 të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 23, pika 1, germa "a", nenin 67, pikat 2, 4, 5, dhe 6, nenin 72, dhe nenin 73, pika 1 dhe pika 2 të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtarë të Këshillin e Bashkive: Tiranë, Lushnje, Durrës, Shkodër të Partisë "Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet", pjesëtare të Koalicionit "Aleanca Për Shqipërinë Europiane", në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Refuzimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtarë të Këshillin e Bashkisë Lezhë të Partisë "Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet", pjesëtare të Koalicionit "Aleanca Për Shqipërinë Europiane", në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 624 i Vendimit

Data 22.05.2019

Ora 17:00 e Vendimit

Për miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive të paraqitura nga "Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet", pjesëtare e Koalicionit "Aleanca Për Shqipërinë Europiane", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019